

Programet i integruar i studimeve të ciklit të dytë (**Master i Shkencave**) në **Planifikim dhe Menaxhim Urban** (300 ECTC, 5 vite akademike)

Profili kulturor dhe profesional

Në përfundim të këtij programi studimi studentët kanë përfunduar një formim të konsoliduar në fushën e Planifikimit dhe Menaxhimit Urban, i cili jo vetëm ofron njohuri teorike dhe praktike në disa aspekte si: planifikimi në nivele të ndryshme; dizajni urban; zhvillimi ekonomik, aspektet mjedisore, ekonomike e sociale; instrumentat e planifikimi dhe zhvillimit, por mbi të gjitha ofron integrimin e këtyre njohurive në një qasje holistike ndaj sfidave të planifikimit.

Temat kryesore që trajton ky program studimi:

- *Thellim i formimit të përgjithshëm*
Topografi, Shkenca toke, Matematike, Histori dhe Mendim i Planifikimit
- *Formim në disiplina ndihmëse*
Ligj dhe legjislacion urban; Ekonomi Urbane; Financa lokale;
- *Formim i thelluar në profesion*
Laboratorë planifikimi (urban; rregullator; rajonal); Teknologji dhe Infrastrukturë qyteti; Sisteme Planifikimi; Studio dhe teori dizajn urban; Planifikim Mjedisor; Dizajn Peizazhi; Plan Veprimi dhe Strategjik. Përveç këtyre studenti do të ketë mundësi të përzgjedhë edhe një sasi të caktuar kreditesh për të mundësuar përafrimin me specifikat dhe kërkesat profesionale personale.

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat i studiove të zhvillimit dhe projektimit urban.
- Nivelit të qeverisjes vendore, duke filluar që nga bashkitë e komunat e deri tek qarku apo rajonet; institucione të nivelit qendror që lidhen me fushën planifikimit
- Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus kryesor fushën e planifikimit, politikave të zhvillimit e menaxhimit urban.

Plani Mësimor si më poshtë vijon:

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Planifikim dhe Menaxhim Urban

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total
A (formim baze i pergjithshem)	Matematike	6	15%
	Topografi	3	
	Histori dhe Mendim i Planifikimit 1	3	
	Histori dhe Mendim i Planifikimit 2	6	
	Histori Arkitekture dhe Qyteti I	6	
	Histori Arkitekture dhe Qyteti II	6	
	Shkenca e tokes	6	
	Metoda te Kerkimit Shkencor	6	
	Ekonomiks	3	
		45	
B (karakterizuese)	Analize territori & vendbanimi 1	6	54%
	Analize territori & vendbanimi 2	6	
	Sistemet e Planifikimit	6	
	Dizajn Peizazhi	6	
	Teknologji dhe Infrastruktura Qyteti 1	6	
	Teknologji dhe Infrastruktura Qyteti 2	6	
	Plan Veprimi / Strategjik	6	
	Rigjenerim Urban dhe Projekte me Komunitetin	6	
	Politika Mjedisore	6	
	Ekonomi Urbane	3	
	Laborator Planifikim Rregullator 1	6	
	Laborator Planifikim Rregullator 2	6	
	Sherbime Publike (menaxhimi i mbetjeve)	6	
	Planifikim Rajonal 1	6	
	Planifikim Rajonal 2	6	
	Politika transporti dhe menaxhim trafiku	6	
	BE dhe Politikat territoriale	6	
	Gjeografi Urbane	6	
	GIS	6	
	Menaxhim i zones bregdetare	6	
	Vleresim I Pasurise se Paluajtshme	6	
	Planifikim Mjedisor	6	
	Studio Planifikimi Urban	6	
Ligj dhe Legjislacion Urban	3		
Qeverisje Vendore	6		
Studio dhe Teori Dizajni Urban	6		

	Demografi	3	
	Urbanistike Teknike	3	
	Plan Biznesi	6	
		162	
C (integruese)	Sipermarrja dhe Biznesi	3	10%
	Marketim Qyteti	6	
	Trashegimia kulturore dhe turizmi	3	
	Statistike	6	
	Gjeometri dhe Dokumentim Grafik	6	
	Financat Lokale	6	
		30	
D (me perzgjedhje)	Lende me perzgjedhje 1	6	6%
	Lende me perzgjedhje 2	6	
	Lende me perzgjedhje 3	6	
		18	
E (formuese plotesuese)	CAD	3	5%
	GIS 2	6	
	Internship Profesional	3	
	Anglisht dhe Shkrim akademik	3	
		15	
F (Pergatitja tezes)	Teza dhe projekt diploma	30	10%
Totali		300	300